

ISH-DIPLOMATI BRITANIK,

DUNCAN: UÇK-ja NUK

KISHTE HIERARKI



Në Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë është duke dëshmuar ish-diplomati britanik John Stewart Duncan, i thirrur nga mbrojtja e ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi. Në fund të viteve '90 Duncan ishte

këshilltar politik i ish-komandantit suprem të Forcave Aleate të NATO-s, Wesley Clark. Ai tha se UÇK-ja, udhëheqës politik i së cilës ishte Thaçi, kishte përbërje heterogjene, “me njerëz me përvoja dhe motive të ndryshme”.

Ai nënvizoi se UÇK-ja nuk kishte hierarki dhe se fuqinë reale të saj e kishin komandantët e zonave. I pyetur nga mbrojtja nëse mendon se Thaçi ishte komandant i përgjithshëm i UÇK-së, ose kryekomandant, ai tha ‘jo’

OPINION

KOSOVA PËRBALLË ZGJEDHJEVE LOKALE. EKONOMI E SHIFRAVE APO EKONOMI E QYTETARËVE?

F. 5

Shkruan:

Safet GËRXHALIU



OPINION



BRITANIA, KANADAJA DHE AUSTRALIA E NJOHIN ZYRTARISHT SHTETIN PALESTINEZ

F. 2

BE-ja URON QEVERINË E RE SHQIPTARE DHE NXIT REFORMAT DREJT INTEGRIMIT

F. 5

EKONOMI



LIGJI

I BLOKUAR NË

KUSHTETUESE

LË QYTETARËT

PA SIGURIME

SHËNDETËSORE

F. 3



UJI NGA

LIQENI I BADOCIT,

SËRISH KA

TENDENCË

PËR RRIJTJE TË

PËRQENDRIMIT

TË MANGANIT

F. 7



AKB-JA: KOSOVA PO MBULOHE

ME BETON, POR PO ZBRAZET NGA

NJERËZIT

F. 8

BQK-ja DHE BQE-ja

NËNSHKRUAJNË MARRËVESHJE

PËR SIGURIMIN E INTEGRITETIT

TË VALUTËS EURO NË KOSOVË

F. 8

RENOVA

PUTZ

Maqedoni

Xhepçisht -Tetovë

Gurëz-Ferizaj

Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009

+389 44 487 755

Fax: +389 44 487 200

Mob: +377 44 501 289

E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA

GROUP SH.P.K.

NDËRTIM

PROJEKTIM

SHITJE

INFO: 049-111-101,

044-511-177

www.princesha-ks.com

Bunjamini

FABRIKA E LLAQEVE

044/256-051

044/367-061

028/532-617

MITROVICË

STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SPORT

ROBERT RRAHMANI, “YLLI I JAVËS”

NË SUPERLIGË

F. 10



Kolegji

BIZNESI

www.kolegji.biznesi.com

info@kolegji.biznesi.com

030 500 878 | 045 500 878

044 500 878 | 049 500 878

SIGMA

VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A

DEGA KOSOVË

Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,

Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,

E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net



INFINITY

Digital Agency

Endrit Shaqiri

+38344685122

Internet Website,

Marketing...

BRITANIA, KANADAJA DHE AUSTRALIA E NJOHIN ZYRTARISHT SHTETIN PALESTINEZ

LONDËR, 22 SHTATOR - Britania e Madhe, Kanadaja dhe Australia e kanë njohur zyrtarisht shtetin palestinez, duke iu bashkuar vendeve të tjera në një lëvizje që synon ringjalljen e përpjekjes për zgjidhjen me dy shtete, por që është kritikuar nga Izraeli dhe Shtetet e Bashkuara.

Kryeministri britanik Keir Starmer tha se vendimi i Britanisë vjen pas dështimit të Izraelit për t'i përmbushur kushtet, përfshirë një armëpushim në luftën gati dyvjeçare në Gazë. "Sot, për ta ringjallur shpresën për paqe për palestinezët dhe izraelitët dhe për një zgjidhje me dy shtete, Mbretëria e Bashkuar njeh zyrtarisht Shtetin e Palestinës" tha kryeministri Keir Starmer në X.

Britania, Kanadaja dhe Australia u bashkohen më shumë se 140 vendeve të tjera në njohjen e shtetit palestinez, por vendimi i tyre pritet t'i zemërojë si Izraelin ashtu edhe aleatet e tij kryesore, Shtetet e Bashkuara.

Britania dhe Kanadaja u bënë vendet e para të grupit të G7-s që ndërmorën këtë hap, ndërsa Franca dhe vende të tjera pritet ta ndjekin shembullin e tyre

gjatë Asamblesë së Përgjithshme vjetore të OKB-së, e cila nis të hënën në Nju-Jork. "Kanadaja njeh Shtetin e Palestinës dhe ofron partneritetin tonë në ndërtimin e premtimit për një të ardhme paqësore si për shtetin e Palestinës, ashtu edhe për shtetin e Izraelit", shkroi kryeministri kanadez Mark Carney në X.

Kryeministri i Australisë, Anthony Albanese, shkroi në rrjetet sociale se vendi i tij ndoqi hapat e Britanisë dhe Kanadasë në njohjen e shtetit palestinez. Ai thotë se kjo është pjesë e një përpjekjeje të përbashkët së bashku me Kanadanë dhe Britaninë dhe do të formojë "një përpjekje ndërkombëtare për një zgjidhje me dy shtete".

Ky është një moment historik për palestinezët dhe shpresat e tyre shumëvjeçare për shtetësi, ndërsa kombet më të fuqishme perëndimore kanë argumentuar për kohë të gjatë se ajo duhet të vijë vetëm si pjesë e një marrëveshjeje të negociuar paqeje me Izraelin. Por, ky hap i këtyre shteteve është kundërshtuar nga Shtetet e Bashkuara dhe Izraeli, pasi kryeministri izraelit, Benjamin



Netanyahu, reagoi me zemërim dhe u zotua ta kundërshtojë atë në mbledhjen e OKB-së.

Thirrjet për një shtet palestinez "do ta rrezikonin ekzistencën tonë dhe do të shërbenin si një shpërblim absurd për terrorizmin", tha Netanyahu të dielën.

Një numër gjithnjë e më i madh aleatësh afatgjatë kanë ndryshuar pozicionin, pasi Izraeli ka shtuar luftën në Gazë, duke u zotuar ta shkatërrojë grupin

militant palestinez, Hamas, i cili është shpallur organizatë terroriste nga ShBA-ja dhe BE-ja.

Gjatë pothuajse dy vjetëve luftë në Gazë, ofensiva izraelite ka vrarë mbi 65 000 palestinezë, sipas autoriteteve shëndetësore në Gazë, ka shkatërruar pjesën më të madhe të ndërtesave dhe ka zhvendosur pjesën më të madhe të popullsisë, në shumë raste disa herë.

Gjakderdhja në Gazë ka nxitur

protesta në qytete të shumta evropiane dhe ka shtuar kritikën ndaj BE-së për paaftësinë e perceptuar për të ushtruar trysni të mirëfilltë mbi Izraelin që t'i ndalojë operacionet ushtarake dhe të lejojë më shumë ndihma humanitare.

Lufta nisi pas sulmit të udhëhequr nga Hamasi në jug të Izraelit, ku militantët vranë rreth 1 200 njerëz dhe rrëmbyen 251 të tjerë, sipas zyrtarëve izraelitë.

KOS NIS VIZITËN TREDITËSHE NË BOSNJË-HERCEGOVINË

SARAJEVË, 22 SHTATOR - Komisionarja për Zgjerim e Bashkimit Evropian, Marta Kos, mbërriti më 22 shtator në një vizitë treditëshe në Bosnjë-Hercegovinë. Ajo u takua tashmë me anëtarin boshnjak të Presidencës së Bosnjë-Hercegovinës, Denis Beqiroviq. Në takim nuk morën pjesë serbja Zheka Cvijanoviç e as kroati Zheko Komshiq.

Gjatë vizitës Kos do të takojë edhe zyrtarë të tjerë të këtij vendi, ndërsa do të flasë edhe para Parlamentit të Bosnjë-Hercegovinës.

Gjithashtu, do të takohet me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, medie, komuniteteve lokale, grave me ndikim në biznes dhe të rinjve nga e gjithë Bosnjë-Hercegovina.

Sipas një njoftimi të Delegacionit të Komisionit Evropian në Bosnjë-Hercegovinë, qëllimi i vizitës është t'i japë mbështetje këtij vendi në rrugën drejt BE-së. "Komisionarja do t'i inkurajojë autoritetet që t'i ndërmarrin të gjithë hapat e nevojshëm për ta realizuar konferencën e parë ndërqeveritare të shumëpritur, dhe do të theksojë rëndësinë që Bosnjë-Hercegovina të mos humbasë mundësinë unike që ofron Plani i Rritjes për



Ballkanin Perëndimor", thuhet në njoftim.

Bosnjë-Hercegovina mori dritën jeshile për negociatën për anëtarësim të plotë në BE në mars të vitit të kaluar, por Brukseli ka paralajmëruar se bisedimet do të fillojnë vetëm pasi vendi të përmbushë një sërë kushtesh. Ato përfshijnë harmonizimin me politikën e jashtme të BE-së, që nënkupton, për shembull, edhe vendosjen e sanksioneve ndaj Rusisë, për shkak të pushtimit të Ukrainës - një vendim ky që kundërshtohet nga përfaqësuesit e entitetit serb të Bosnjës, Republika Srpska.

Një tjetër kusht është shmangia e diskriminimeve etnike dhe territoriale në zgjedhjen e anëtarëve të Presidencës, si dhe reforma e Gjykatës Kriminale dhe Gjykatës Kushtetuese.

Brukseli ka paralajmëruar se pa një plan të qartë reformash dhe pa zbatimin e tij, Bosnjë-Hercegovina nuk do të marrë as fonde të BE-së e as kredi me kushte të favorshme.

Shuma e parë prej 108 milionë eurosh nga rreth një miliard euro të planifikuara me Planin e Rritjes për Bosnjën u ridrejtua verën e kaluar drejt vendeve të tjera.

Në tetor, Bosnja mund të humbasë një shumë të ngjashme, pasi Komisioni Evropian ka theksuar se fondet do t'u jepen atyre që avancojnë, jo atyre që mbeten pas.

Çfarë është Plani i Rritjes?

Plani i Rritjes prej gjashtë miliardë eurosh përfshin investime dhe reforma për vendet e Ballkanit Perëndimor si pjesë e agjendës reformuese për periudhën 2024-2027. Nga kjo shumë, dy miliardë janë në

formë granti, ndërsa katër miliardë euro janë në formë kredie me këste shumë të favorshme.

Plani synon t'i përshpejtojë reformat dhe t'i përgatisë ato për anëtarësim.

Qëllimi kryesor është mbështetja për harmonizimin e partnerëve nga Ballkani Perëndimor me vlerat, ligjet, rregullat, standardet, politikat dhe praktikën e BE-së, me qëllim të anëtarësimit të ardhshëm në BE, si dhe integrimin progresiv të tyre në një treg të vetëm evropian, si dhe konvergjencën socio-ekonomike me BE-në.

Burimet financiare janë planifikuar për të mbështetur një sërë reformash socio-ekonomike dhe themelore, duke përfshirë reformat që lidhen me sundimin e ligjit dhe të drejtat themelore.

Parakushtet e përgjithshme për mbështetjen e BE-së, sipas Planit të Rritjes, përfshijnë mbështetjen dhe respektimin e vazhdueshëm për mekanizmat efektivë demokratikë, duke përfshirë një sistem parlamentar shumëpartiak, zgjedhje të lira dhe të ndershme, media pluraliste, një gjyqësor të pavarur dhe sundim të ligjit, si dhe garantimin e respektimit të të drejtave të njeriut, duke përfshirë të drejtat e pakicave.

LIGJI I BLOKUAR NË KUSHTETUESE LË QYTETARËT PA SIGURIME SHËNDETËSORE



PRISHTINË, 22 SHTATOR - Kur kulmi i një shtëpie që digej i ra mbi trup, zjarrfikësi Afrim Gashi nuk mendoj vetëm për dhimbjen dhe shërimin. Mendja i shkoi edhe te shpenzimet: “A do të mund të paguaj? A do të shkoj në spital privat apo shtetëror? A janë barnat shumë të shtrenjta...”. Për 23 vjet sa është në shërbim, ai thotë se është lënduar disa herë dhe se gjithmonë i ka mbuluar shpenzimet vetë - nga kursimet personale. Ky nuk është vetëm fati i këtij zjarrfikësi nga Prishtina. Të gjithë kolegët e tij, ashtu si edhe policët dhe qytetarët e tjerë të Kosovës, mbeten pa sigurim shëndetësor funksional, pavarësisht se Ligji për Sigurimin e Detyrueshëm Shëndetësor u miratua nga Kuvendi i Kosovës më 5 dhjetor 2024.

Ngarkesë e madhe, rrezik i vazhdueshëm

Brigada e zjarrfikësve në Prishtinë - pjesëtar i së cilës është edhe Gashi - vetëm në tre muajt e fundit është detyruar të ndërhyjë deri në 30 raste brenda një dite. Përveç kryeqytetit, ata kanë shkuar edhe në fshatrat përreth, por shpesh edhe në komuna të tjera, si: Podujeva, Obiliqi, Istogu e Graçanica. Ndërhijet e rrezikshme shpesh përfundojnë me lëndime, thotë Gashi për “Radion Evropa e Lirë”. “Krahas dhimbjes e problemeve që vijnë me lëndimet, neve na rri mendja

edhe te shpenzimet. Dhe kjo ndikon drejtpërdrejt në xhepin tonë”, shprehet 45-vjeçari.

Ligji i bllokuar në Gjykatën Kushtetuese

Edhe pse Kuvendi e miratoi Ligjin për Sigurimin e Detyrueshëm Shëndetësor, ai nuk ka hyrë ende në fuqi. Partia Demokratike e Kosovës e kontestoi në Gjykatën Kushtetuese, duke pretenduar se ka pasur shkelje procedurale. E kontaktuar nga “Radio Evropa e Lirë”, Kushtetuesja konfirmoi vetëm se ka pranuar kërkesën më 13 dhjetor të vitit 2024, por ende - as pas nëntë muajsh - nuk ka marrë vendim. Në Ministrinë në detyrë të Shëndetësisë thonë se janë në pritje të aktgjykimit por, ndërkohë, edhe duke punuar në drejtim të zbatimit të ligjit. “Në funksion të krijimit të parakushteve për funksionalizimin e plotë të sigurimeve shëndetësore, Ministria e Shëndetësisë ka formuar grupet punuese për hartimin e dokumenteve strategjike - të domosdoshme për zbatimin e ligjit”, thuhet në përgjigjen e Zyrës për Medie të Ministrisë së Shëndetësisë, dërguar “Radios Evropa e Lirë”. Shërbimet në institucionet publike shëndetësore në Kosovë ofrohen pa pagesë vetëm për kategori të caktuara, si fëmijët, pensionistët apo rastet sociale, ndërsa për të tjerët vlen bashkëpagesa për kujdes shëndetësor. Shuma e saj varion - nga 1 deri

në qindra euro - varësisht nga shërbimi që merr pacienti. Për ato trajtime që nuk realizohen në institucionet publike, përgjegjësinë e mbulimit të kostove e ka Fondi i Sigurimeve Shëndetësore, i cili menaxhohet nga Ministria e Shëndetësisë. Vitin e kaluar ky fond kishte 12 milionë euro, prej të cilave 99% u shpenzuan. Por procedurat burokratike, derisa pacientët t’i marrin mjetet e nevojshme, zgjasin me javë të tëra, e nganjëherë edhe muaj. Ndaj, shumë qytetarë - përfshirë edhe zjarrfikësin Afrim Gashi - detyrohen t’i përballojnë vetë shpenzimet - qoftë në spitale private, qoftë jashtë shtetit. Sigurime shëndetësore kanë vetëm ata që i marrin nga kompanitë private.

Ekspertët: Mungesë kapacitesh dhe vullneti politik

Profesori i politikave shëndetësore, Liridon Bllaca, e sheh moszbatimin e ligjit si tregues të mungesës së përgatitjes institucionale. “Implementimi i sigurimit shëndetësor kërkon infrastrukturë të qartë, mekanizma për mbledhjen e kontributeve, administrim të drejtë të fondeve dhe një strategji të mirë për përfshirjen e të gjithë qytetarëve - pra edhe të atyre që punojnë në sektorin joformal. Me aq sa di unë, Qeveria nuk ka ndërmarrë hapa në këto drejtime. Kam frikë se edhe nëse nis,

implementimi do të sjellë shumë probleme”, thotë Bllaca për “Radion Evropa e Lirë”. Ai shton se në mungesë të sigurimeve shëndetësore, qytetarët paguajnë shpesh nga xhepi, e disa “heqin dorë krejtësisht nga trajtimi mjekësor”. Bujar Vitija, kryeredaktor i gazetës “Shneta”, që raporton për sektorin e shëndetësisë në Kosovë, thotë se situata është pasojë e mungesës së vullnetit politik. “Ligji ekziston që nga viti 2014, por asnjë qeveri nuk e ka zbatuar. Problem nuk ka qenë ligji, por mungesa e vullnetit për ta bërë realitet. Jemi vendi i vetëm në Evropë pa sigurime shëndetësore”, thotë Vitija për “Radion Evropa e Lirë”. Për Besim Kodrën, nga Shoqata e të Drejtave të Pacientëve, problemi është edhe më i thellë. Institucionet shëndetësore, sipas tij, shpesh nuk i plotësojnë kushtet për shërbime, ndërsa Fondi i Sigurimeve nuk ka kapacitet profesional për ta menaxhuar procesin. Ai punon me staf të limituar prej rreth 50 punëtorësh, ndërsa do të duheshin rreth 400 syresh. “Në një situatë të tillë, në vend që t’u jepet siguri qytetarëve, ekziston rreziku i falimentimit të vetë fondit”, thotë Kodra. Ligji i kontestuar parashikon që punëdhënësit dhe punëtorët të paguajnë nga 3.5 për qind të pagës bruto - gjithsej 7 për qind - por mbetet e paqartë se kur dhe si do të fillojë mbledhja e këtyre kontributeve. Partitë politike, në çdo fushatë

zgjedhore, premtojnë sigurime shëndetësore, duke dhënë afate që kurrë nuk mbahen. “Një sigurim i tillë do të na kishte ndihmuar shumë”, thotë Gashi, i cili bashkë me shumë kolegë të reagimit të shpejtë rrezikojnë veten për të shpëtuar të tjerët.

Saga e sigurimeve shëndetësore

Historia e sigurimeve shëndetësore në Kosovë është e gjatë dhe e komplikuar. Ligji i parë u miratua që në vitin 2007, por kurrë nuk hyri në fuqi, pasi shefi i atëhershëm i Misionit të Kombeve të Bashkuara nuk e nënshkroi. Pas shpalljes së pavarësisë në vitin 2008, qeveritë e Kosovës e tërhoqën ligjin, duke u justifikuar me pasojat buxhetore që do t’i kishte zbatimi i tij. Më 2014 Kuvendi miratoi një ligj të ri. Zbatimit të tij do të duhej t’i paraprinte një periudhë prej gjashtë muajsh për mbledhjen e fondeve, e cila do të niste nga 1 korriku i vitit 2017. Qeveria kishte ndarë 17 milionë euro për këtë qëllim, por këto mjete u ridestinuuan më pas për pagesat e pensioneve të veteranëve të luftës. Deri vitin e kaluar, kur u miratua ligji i ri për sigurime shëndetësore, nuk kishte ndonjë hap tjetër sa i përket kësaj mase.



ISH-DIPLOMATI BRITANIK, DUNCAN: UÇK-ja NUK KISHTE HIERARKI

Në Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë është duke dëshmuar ish-diplomati britanik John Stewart Duncan, i thirrur nga mbrojtja e ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi. Në fund të viteve '90 Duncan ishte këshilltar politik i ish-komandantit suprem të Forcave Aleate të NATO-s, Wesley Clark. Ai tha se UÇK-ja, udhëheqës politik i së cilës ishte Thaçi, kishte përbërje heterogjene, “me njerëz me përvoja dhe motive të ndryshme”. Ai nënvizoi se UÇK-ja nuk kishte hierarki dhe se fuqinë reale të saj e kishin komandantët e zonave. I pyetur nga mbrojtja nëse mendon se Thaçi ishte komandant i përgjithshëm i UÇK-së, ose kryekomandant, ai tha ‘jo’

HAGË, 22 SHTATOR - Në Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë është duke dëshmuar ish-diplomati britanik John Stewart Duncan, i thirrur nga mbrojtja e ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi. Në fund të viteve '90 Duncan ishte këshilltar politik i ish-komandantit suprem të Forcave Aleate të NATO-s, Wesley Clark, i cili udhëhoqi fushatën ajrore të NATO-s kundër qeverisë ushtarake serbe, më 1999. Në fillim të dëshmisë, mbrojtja e pyeti nëse ka mbuluar edhe punën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës gjatë veprimtarisë së tij - në çka ai u përgjigj me ‘po’. Ai tha se UÇK-ja, udhëheqës politik i së cilës ishte Thaçi, kishte përbërje heterogjene, “me njerëz me përvoja dhe motive të ndryshme”. “Ne e quanim atë ‘ushtria e atyre që nuk kishin asgjë’. Aspiratat e tyre nuk ishin të njëjta. Motivi i tyre nuk ishte i

njëjtë. Kur filloi të përshkallëzohej spastrimi etnik, përbërja e pjesëtarëve kryesorë ishte shumë e larmishme: kishte ish-ushtarë të Armatës Jugosllave, juristë, mjekë, gazetarë dhe njerëz të tjerë, disa me familje të keqtrajtuara. Arsyeja që morën armët, ndryshonte nga personi në person”, rrëfeu Duncan, ka raportuar “Radio Evropa e Lirë”. “Kjo ishte vështirësia me të cilën përballeshim atje”, tha Duncan, sepse “nuk kishin strukturë hierarkike - ishin të organizuar ndryshe”. Sipas tij, udhëheqja politike e UÇK-së, përfshirë edhe Thaçin, shpesh nuk ishte në gjendje t'i bindte ushtarët për vendime të rëndësishme, siç ishte çarmatosja. Ai tha se roli i Thaçit nuk pasqyronte realitetin

politik dhe se nuk kishte legjitimitet të plotë në shoqëri. “Atje kishte disa forca politike si LDK-ja, zoti Rugova e të tjerë”, tha Duncan. I pyetur nga mbrojtja nëse mendon se Thaçi ishte komandant i përgjithshëm i UÇK-së, ose kryekomandant, ai tha ‘jo’. “...sepse mënyra se si silleshin [komandantët] me të gjatë negociatave, ishte e tillë që ata e trajtonin si krah politik, që kishte një lloj ndikimi, por jo si dikush që kishte kompetenca ushtarake”. “Asnjëherë nuk e kam parë [Thaçin] që të jepte direktiva apo urdhra”, tha Duncan. Informacionet për Kosovën, Duncan tha se i merrte nga burime të ndryshme. “Së pari, lexoja të gjitha informacionet në internet për 24 orët e fundit lidhur me Kosovën. Më pas dëgjoja lajmet e fundit, BBC-

në... shqyrtoja të gjitha kabllogramet diplomatike, shërbimet e monitorimit dhe më pas hyja në takime dhe informoja gjeneralin Clark. Po ashtu, bisedoja edhe me gazetarë dhe organizata joqeveritare për të marrë sa më shumë informacion”, tha Duncan, teksa përshkroi, siç u shpreh ai, një ditë të zakonshme pune të asaj kohe. “Detyrat e mia kryesore ishin t'u jepja këshilla komandantëve ushtarakë lidhur me aspektet politike dhe diplomatike, por edhe t'i udhëzoja për mënyrën e reagimit dhe ndikimin e tyre në operacionet përkatëse”, shtoi Duncan. Ai kishte shërbyer edhe në Shqipëri pas rënies së komunizmit. “Ky ishte një shtet i mbyllur për 46 vjet, dhe unë isha vërtet i interesuar të kuptoja se si funksiononte shoqëria, sepse kjo ishte baza e detyrës sonë si diplomatë. Ne duhej t'u shpjegonim eprorëve tanë si funksionon shoqëria, çfarë ndodh brenda saj, si veprojnë pushtetet, çfarë mund të ndikosh tek ata dhe pse ndonjëherë mund të jenë të vështirë. Kjo është puna e një diplomati - t'ua shpjegojë të gjitha aspektet e një shoqërie eprorëve përkatës”, tha Duncan.

Sipas kryesuesit të trupit gjykues, Charles Smith III, dëshmia e këtij dëshmitari do të zgjasë dy ose tri ditë. Mbrojtja e Thaçit dhe e ish-krerëve të tjerë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), të akuzuar për krime lufte, ka thirrur gjithsej 11 dëshmitarë, të cilët do të paraqiten gjatë javëve në vazhdim. Dy dëshmitarë të tjerë do të paraqiten nga mbrojtja e Jakup Krasniqit, ndërsa mbrojtja e Kadri Veselit dhe Rexhep Selimit ende nuk ka thirrur dëshmitarë. Dëshmia e mbrojtjes nisi javën e kaluar me ish-ndihmësin e sekretarit amerikan të Shtetit, James Rubin, dhe këshilltarin ligjor të delegacionit të Kosovës gjatë negociatave në Rambuje më 1999, Paul Williams. Rubini gjatë tri ditëve foli kryesisht për rolin e Thaçit në luftë, për të cilin tha se ishte politik dhe nuk kishte kompetenca për vendime ushtarake brenda UÇK-së. Rubini tha se nuk ka asnjë informacion që e lidh Thaçin ose Krasniqin me pretendimet për vrasje. Williamsi, gjatë dëshmisë së tij, tha se Thaçi përfaqësonte UÇK-në si negociator i besueshëm, por nuk kishte autoritet të plotë mbi komandantët rajonalë.

Kurti: E kam ndjekur pjesërisht dëshminë e Rubinit, qëndrimi për Specialen s'ka ndryshuar

PRISHTINË, 22 SHTATOR - Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ka deklaruar se ka ndjekur pjesërisht dëshminë e ish-zyrtarit të lartë amerikan, James Rubin, në Dhomat e Specializuara të Kosovës (DhSK) të Gjykatës Speciale. "E kam ndjekur pjesërisht, sa kam mundur për shkak të angazhimeve dhe aktiviteteve të shumta. Mbrojtja është përcaktuar për një orientim të veçantë, roli ynë është i kufizuar. Ne kemi dhënë mbështetje

financiare në mënyrë të pandërprerë dhe shpresojmë për më të mirën. Por, qëndrimi im për Gjykatën Speciale mbetet i njëjtë që nga fillimi", ka thënë Kurti para gazetarëve. I pyetur për faktin që Adem Demaçi po përmendet si kryesori, Kurti ka refuzuar të përgjigjet. "Besoj se duhet të presim zhvillimin e këtij procesi pa dhënë vlerësime politike. Edhe njëherë theksoj se qëndrimi im për Gjykatën Speciale nuk ka ndryshuar asnjëherë". Ai,


gjithashtu, nuk është përgjigjur nëse beson se ish-krerët e UÇK-së do të shpallen të pafajshëm. Për tri ditë me radhë në Gjykatën Speciale dëshmoi ish-zyrtari i lartë amerikan, James Rubin. Rubini foli mbi rolin e Hashim Thaçit dhe autoritetin e tij në UÇK, mungesën e një shtabi të përgjithshëm, paraburgimin e ish-krerëve të UÇK-së dhe trajtimin e tyre. Ai përmendi edhe ndikimin e figurave politike mbi Thaçin gjatë viteve 1998-1999.



BE-ja URON QEVERINË E RE SHQIPTARE DHE NXIT REFORMAT DREJT INTEGRIMIT

TIRANË, 22 SHTATOR - Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri ka uruar kryeministrin Edi Rama dhe kabinetin e tij të ri për marrjen e detyrës. Në një deklaratë zyrtare, BE-ja nënvizon se me përpjekje të qëndrueshme në miratimin dhe zbatimin e reformave të nevojshme, në mënyrë transparente dhe gjithëpërfshirëse Shqipëria mund ta arrijë qëllimin ambicioz të mbylljes së negociatave të anëtarësimit deri në fund të vitit 2027. "Presim të punojmë së bashku me të gjithë aktorët shqiptarë në përmbushjen e këtij objekti të rëndësishëm, në dobi të qytetarëve shqiptarë", thuhet më tej në deklaratë.

Kryeministri dhe ministrat e kabinetit të ri të qeverisë 'Rama 4' u betuan gjatë javës së kaluar para presidentit të Republikës Bajram Begaj. Pas leximit të Dekretit të presidentit për emërimin e Këshillit të Ministrave, ministrat e rinj u betuan me dorën mbi Kushtetutë sipas formulës së betimit: "Betohe me nderin tim, se do të zbatoj me përpikëri Kushtetutën dhe ligjet, si dhe do të kryej me përgjegjësi detyrën shumë të rëndësishme që më është besuar, të anëtarit të Këshillit të Ministrave!". Betimi erdhi një ditë pas kaosit



në Kuvend, ku u votëbesuan në një seancë që zgjati vetëm 25 minuta. Kabineti i ri qeveritar, i paraqitur nga kryeministri Edi

Rama në Asambleenë Kombëtare të Partisë Socialiste, sjell kombinim të figurave të njohura me ministra të rinj që

hyjnë për herë të parë në ekzekutiv. Disa prej tyre vazhdojnë të mbajnë postet aktuale, disa

kanë kaluar nga një dikaster në tjetrin, ndërsa emra të rinj i janë shtuar skuadrës së qeverisë së katërt të Ramës.

Kupchan: Dëmtimi i marrëdhënieve me ShBA-në do të ishte vetëshkatërrues për Kosovën

PRISHTINË, 22 SHTATOR - Charles Kupchan, nga Këshilli për Marrëdhënie me Jashtë në Uashington, pas pezullimit të dialogut strategjik nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA), ka thënë se nëse Qeveria e Kosovës vazhdon t'i dëmtojë marrëdhëniet me një aleat kaq të fortë si ShBA-ja, do të ishte e papërgjegjshme dhe vetëshkatërruese. "Mendoj se do të ishte e papërgjegjshme dhe vetëshkatërruese nëse Qeveria e Kosovës vazhdon të ndër marrë hapa që dëmtojnë

marrëdhënien me një vend që ka qenë një mbështetës aq i fortë", ka thënë Kupchan. Sipas tij, Kosova mund të ruajë marrëdhënie të mira me ShBA-në dhe Evropën vetëm përmes një qasjeje konstruktive në dialog. "Kosova mund të mbajë marrëdhënie të mira me Evropën dhe ShBA-në vetëm nëse shihet se po negocion me mirëbesim dhe në mënyrë konstruktive, për të çuar rajonin përpara", u shpreh Kupchan për "Radio Evropën e Lirë".

Marrëdhëniet në mes të Prishtinës dhe Uashingtonit janë dobësuar ndjeshëm kohët e fundit, kryesisht për shkak të bindjes së administratës amerikane se kryeministri në detyrë, Albin Kurti, nuk ka treguar gatishmëri për bashkëpunim, pavarësisht prej thirrjeve, rekomandimeve dhe përkushtimit ndaj Kosovës. Për këtë arsye dy javë më parë ambasada e ShBA-së në Prishtinë njoftoi se dialogu strategjik me Kosovën është pezulluar.



KOSOVA PËRBALLË ZGJEDHJEVE LOKALE. EKONOMI E SHIFRAVE APO EKONOMI E QYTETARËVE?



Shkruan:
Safet GËRXHALIU

Iluzioni i rritjes!

Për vite me radhë jam marrë me ekonominë e Kosovës, si analist, si përfaqësues i biznesit dhe si qytetar i këtij vendi. Kam dëgjuar shpallje për rritje ekonomike, për progres, për fitore në statistika. Por kam parë edhe fytyrën e vërtetë të tregut: qytetarin që varfërohet përditë nga inflacioni, biznesin që mbijeton me kosto të larta, të rinjtë që largohen sepse nuk shohin perspektivë. Kosova sot është në udhëkryq. Në letër kemi rritje; në realitet kemi varfërim. Në fjalime kemi sovranitet; në përditshmëri kemi pasiguri. Dhe pikërisht në këtë sfond mbahen zgjedhjet komunale - një provë e madhe për të ardhmen e vendit. Inflacioni: tatimi i padukshëm mbi qytetarin. Inflacioni është bërë problemi më i madh i përditshëm. Çdo muaj, qytetarët blejnë më pak

me të njëjtat të ardhura. Një rritje nominale e PBB-së pa kontroll mbi inflacionin është një mashtrim makroekonomik. Siç thoshte Milton Friedman, inflacioni është tatimi më i padrejtë, sepse e godet më shumë atë që ka më pak. Kjo është ajo që po ndodh sot: më të varfrit dhe shtresa e mesme po mbajnë barrën e "rritjes" së shpallur në konferenca.

Nga toka te kapitali: themelet e krisura të ekonomisë

Problemet nuk kufizohen te çmimet. Ato shtrihen në çdo sektor, duke e bërë ekonominë të brishtë. Bujqësia mbetet e harruar. Tokat janë të fragmentuara, mekanizimi i kufizuar, zinxhiri i përpunimit pothuaj inekzistent. Kosova importon ushqime bazë ndërkohë që fermeri vendas lufton të shesë prodhimin. Një vend që nuk ushqen vetveten, nuk mbron dot as sovranitetin ekonomik. Energjia është pasiguria më e madhe. Termocentralet e vjetra nuk garantojnë furnizim stabil, humbjet në rrjet janë alarmante, çmimet rriten. Bizneset kanë dalë në rrugë për të protestuar kundër tarifave - dhe kur biznesi proteston për energjinë, ky nuk është më problem teknik, por

krizë shoqërore. Industria dhe eksportet janë të nënzhvilluara. Pa fabrika moderne, pa teknologji, pa certifikime ndërkombëtare, Kosova mbetet konsumator, jo prodhues. Deficiti tregtar nuk është vetëm statistikë, është dëshmi e një ekonomie që nuk gjeneron vlerë të shtuar. Sistemi financiar ka humbur moralin e tij. Bankat nuk financojnë prodhim e inovacion, por spekulim me pasuri të paluajtshme. Edhe pse raportet flasin për diversifikim kredish, realiteti është ndryshe: shumica e huave përdoren për tokë dhe banesa, në Kosovë e Shqipëri. Ky është model i rrezikshëm, sepse nuk krijon zhvillim, por filluska. Investimet e huaja nuk po hyjnë aty ku duhet. Në vend të fabrikave, kapitali i huaj kanalizohet në pasuri të paluajtshme. Ky kapital nuk krijon vende pune, nuk sjell teknologji, nuk rrit eksportin. Përkundrazi, rrit çmimin e banesave, duke e bërë strehimin luks për qytetarët. Arsimi dhe puna janë kthyer në paradoks. Universitetet nxjerrin diploma, por jo shkathtësi praktike. Të rinjtë nuk gjejnë punë dhe ikin. Kosova humb kapitalin më të çmuar - rininë. Një vend që humb rininë, humb të ardhmen. Dhe mbi të gjitha, institucionet e

dobëta e rëndojnë çdo plagë. Ligjet ekzistojnë, por nuk zbatohen. Gjykatat vonojnë, korrupsioni i gërryen institucionet, burokracia ngulfat biznesin. Pa institucione të forta, asnjë ekonomi nuk ngrihet.

Roli i komunave: fuqia që shpesh harrohet

Shumëkush mendon se vetëm qeveria qendrore mund të ndryshojë ekonominë. Në fakt, pushteti lokal ka kompetenca reale që prekin përditshmërinë e qytetarit. Dhe pikërisht kjo e bën të rëndësishme peshën e zgjedhjeve që po mbahen.

- Komunat kontrollojnë urbanizimin dhe tregun e ndërtimit. Një komunë mund të ndalë ndërtimet spekulative, të vendosë rregull dhe të ndikojë drejtpërdrejt në çmimet e banesave.
- Komunat krijojnë tregje lokale. Nëse fermeri ka hapësirë për të shitur prodhimin, qytetari blen më lirë dhe ekonomia lokale merr frymë.
- Komunat ofrojnë shërbime publike - ujë, mbeturina, ndriçim, transport lokal. Cilësia e këtyre shërbimeve përcakton standardin e jetesës dhe kostot për biznesin.
- Komunat mund të lidhin partneritete publike-private për infrastrukturë, parqe

industriale, shërbime të reja.

- Komunat mund të jenë shembull transparence. Një kryetar që udhëheq me llogaridhënie e forcon besimin në shtet - dhe besimi është kapital i pazëvendësueshëm. Nëse qeveria qendrore flet për shifra, komuna flet për jetën e përditshme. Aty matet shteti.

Përfundim: nga iluzioni te përgjegjësia

Kosova nuk ka luksin të vazhdojë me dy iluzione: me nacionalizëm të zbrazët dhe me rritje ekonomike në letër. Një shtet nuk matet me raporte statistikash, por me dinjitetin e qytetarit të tij. Një ekonomi e vërtetë është ajo që i jep të riut arsye të qëndrojnë, që i jep punëtorit siguri, që i jep familjes banesë të përballueshme. Si ekonomist dhe ish-kryetar i Odës Ekonomike, e di nga përvoja se besimi i qytetarit dhe i biznesit nuk fitohet me fjalë, por me institucione funksionale dhe me ekonomi reale. Kryetarët që do të zgjidhen në këto zgjedhje kanë përgjegjësi historike: të tregojnë se pushteti lokal mund të bëhet ura e zhvillimit, jo thjesht zyra e administrimit. Kosova ka nevojë për një kthesë. Jo më iluzione, por vepra. Jo më ekonomi të shifrave, por ekonomi të qytetarëve.

KEDS-i po investon mbi 100 mijë euro në Mitrovicën e Veriut

MITROVICË, 22 SHTATOR - KEDS-i po vazhdon projektet investive në tërë territorin e Kosovës, duke mos lënë anash as Mitrovicën e Veriut. Ky angazhim i kompanisë dëshmon përkushtimin që të gjithë qytetarët të përfitojnë nga një infrastrukturë moderne energjetike dhe një furnizim i qëndrueshëm me energji elektrike, pa dallim regjioni komune. Paralelisht me rrjedhën e Lumit Ibër, duke nisur nga ura kryesore, përgjatë tre soliterëve, në drejtim të Suhodollit, KEDS-i po realizon një projekt të rëndësishëm në Tensionin e Mesëm 10 kV, në Daljen e Bergjanit, i cili do të përmirësojë ndjeshëm cilësinë dhe sigurinë e furnizimit me energji elektrike për konsumatorët e asaj zone. Ky projekt është i një rëndësie të veçantë, pasi prek drejtpërdrejt jetën e përditshme të banorëve, duke u ofruar një shërbim më stabil dhe me më pak ndërprerje. Gjatësia e linjës së re është afro 5.5 kilometra, nga të cilat 3.1 kilometra janë rrjet kabllorik

nëntokësor dhe 2.38 kilometra rrjet ajror. Gjithashtu, janë duke u ndërtuar edhe katër kthina të reja, të cilat rrisin sigurinë dhe efikasitetin e rrjetit. Për më tepër, projekti përfshin edhe qindra metra të tensionit të ulët ajror dhe nëntokësor. Këto elemente janë thelbësore për garantimin e një shpërndarjeje më cilësore dhe më të qëndrueshme të energjisë. Falë këtij investimi, qindra konsumatorë në Mitrovicën e Veriut do të kenë një furnizim më të qëndrueshëm me energji elektrike. Përveç rritjes së cilësisë së shërbimit, investime të tilla ndikojnë edhe në rritjen e sigurisë së rrjetit elektrik. Kjo nënkupton se përfitimi është i shumëfishtë: konsumatorët marrin një shërbim më të mirë, ndërsa rrjeti bëhet më efikas dhe më i besueshëm. KEDS-i ka njoftuar se mbetet i përkushtuar që të trajtojë me prioritet të barabartë të gjitha komunat dhe zonat e Kosovës pa dallim. "Ky nuk është projekti i vetëm që po e bën kompania në pjesën veriore të vendit. Aty janë implementuar



ose janë në proces implementimi edhe disa projekte të tjera, të cilat bëhen për t'ua përmirësuar jetën qytetarëve të asaj ane, duke rritur stabilitetin dhe sigurinë e

furnizimit. Ky është vetëm një nga shumë projektet që KEDS-i po i realizon anëmbanë Kosovës, në kuadër të strategjisë së tij për modernizimin dhe zgjerimin e rrjetit elektrik. Kjo



strategji synon që në çdo qytet e çdo fshat të ofrohet infrastrukturë bashkëkohore, e cila i shërben zhvillimit ekonomik dhe mirëqenies së qytetarëve", ka njoftuar KEDS-i.

Osmani kërkon mbështetje nga Liga Arabe për njohjen e Kosovës

PRISHTINË, 22 SHTATOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka zhvilluar një takim në Nju-Jork me sekretarin e përgjithshëm të Ligës Arabe, Ahmed Aboul Gheit. “Në Nju-Jork zhvillova një takim me Sekretarin e Përgjithshëm të Ligës Arabe, Ahmed Aboul Gheit”, ka njoftuar Osmani. Në këtë takim Osmani ka

theksuar rëndësinë e bashkëpunimit në mes të Kosovës dhe Ligës Arabe, duke nënvizuar nevojën që shtetet anëtare të kësaj organizate, të cilat ende nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës, të ndërmarrin këtë hap. “Theksova rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet Kosovës dhe Ligës Arabe, si dhe nevojën për

mbështetje në procesin e njohjes së Kosovës nga shtetet anëtare të kësaj organizate që ende nuk e kanë ndërmarrë këtë hap”, ka bërë me dije Osmani. Ajo tha se mbështetja e Ligës Arabe është thelbësore për forcimin e pozitës ndërkombëtare të Kosovës dhe për avancimin e marrëdhënieve me vendet arabe.




VDIQ AKTORI ENVER PETROVCI

PRISHTINË, 22 SHTATOR - Ka vdekur në moshën 71-vjeçare aktori nga Kosova, Enver Petrovci, bëri me dije Teatri Kombëtar i Kosovës më 22 shtator. “Teatri Kombëtar i Kosovës u shpreh ngushëllimet më të sinqerta familjes Petrovci, kolegëve, miqve dhe gjithë publikut që e ka çmuar dhe e ka dashur veprën e tij artistike dhe pedagogjike”, u tha në njoftim.

Petrovci lindi në Prishtinë më 1954 në Prishtinë, ku kreu shkollimin fillor dhe të mesëm. Më pas kreu studimet në Degën e Aktrimit në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë.

Më 1978 përfundoi studimet universitare për aktor në Fakultetin e Arteve Dramatike



në Universitetin e Beogradit. Si student, me shfaqjet “Mblerësia” dhe Martesa”, ai mori pjesë në të gjitha festivalet në ish-Jugosllavi, ndërkaq pas diplomimit punoi në Teatrin Jugosllav të Dramës.

Kur nisi përkeqësimi i krizës në ish-Jugosllavi ai u largua nga Beogradi dhe vazhdoi karrierën në Prishtinë, duke luajtur në disa shfaqje. Në këtë periudhë, Petrovci u angazhua edhe në disa teatro të rajonit.

Në fillim të viteve '90 u zgjodh ligjërues i aktrimit dhe diksionit në Fakultetin e Arteve në Prishtinë. Ai ishte themelues dhe drejtues i Teatrit Dododa në Prishtinë nga viti 1990 deri më 1993. Pasi u largua nga Dododa, Petrovci themeloi shkollën e

parë private të aktrimit në Prishtinë “Actor's Studio”. Pas përfundimit të luftës në Kosovë, kjo studio themeloi Akademinë e Arteve dhe më pas shtëpinë e teatrove “Teatri i Babës”.

Gjatë karrierës së tij të gjatë si aktor, Petrovci luajti një numër të madh rolesh në teatër, dhe luajti në dhjetëra filma, seriale, drama televizive, kryesisht në role kryesore.

Për rolet e tij ai është shpërblyer me çmime nga festivale të ndryshme. Më 2023 Universiteti i Prishtinës i ndau Enver Petrovcit titullin “Profesor Emeritus”, teksa ai vlerësohej se ishte ndër themeluesit e katedrës së aktrimit në Fakultetin e Arteve në Prishtinë.

PËRURORHET SHTATORJA E HEROIT AFRIM ZHITIA

PODUJEVË, 22 SHTATOR - Kryeministri në detyrë Albin Kurti, i shoqëruar nga ushtruesi i detyrës së ministrit të Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Hysen Durmishi dhe kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, deputetë dhe ministra, familjarë të dëshmorëve, invalidë dhe veteranë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, mori pjesë në ceremoninë përkujtimore dhe përrurimin e shtatores së heroit të kombit Afrim Zhitia.

Në fjalën e tij hapëse, kryeministri Kurti tha se, teksa po i afrohem

përmbushjes së dekadës së katërt prej rënies së tyre, jemi bashkuar këtu në fshatin Llugë, në vendlindjen e Afrim Zhitisë, për të inauguruar një tjetër formë të përkujtimit të figurës së Afrim Zhitisë dhe veprës së tij.

Duke përshkruar figurën e Afrim Zhitisë, i cili si 16-vjeçar nisi udhëtimin e tij politik, kryeministri tha se, katër vitet që i kaloi në burg si i dënuar për aktivitetin politik të tij, i shtuan Afrimit përvojë jetësore dhe lexime teorike, duke i dhënë atij profilin e aktivistit politik shqiptar e progresist që



angazhohet tërësisht për çlirimin e atdheut dhe për barazi e drejtësi. Nga burgu në përpjekje për liri, te jeta dhe te lufta për liri bashkë me Fahriun dhe me shokët e tjerë që ranë gjatë rrugës apo edhe ata që patën jetë ta jetojnë lirinë të gjallë deri sot mes nesh. “Shtatorja e Afrim Zhitisë këtu në Lluga, e monumentalizon figurën e tij historike në një veper publike arti. Por që të plotësohet e tërë infrastruktura kulturore e bartjes ndër gjenerata të historisë së Afrim Zhitisë dhe Fahri Fazliut, sikurse edhe historisë së Bahri

Faziut, Agron Rrahmanit, historisë së Zahir Pajazitit, Hakif Zejnullahut dhe të dëshmorëve të tjerë dhe shokëve të tyre luftëtarë, kemi nevojë edhe për më shumë studime të thelluara dhe më shumë botime shkencore. Për vepra të shkruara, pra kemi nevojë, sepse e shkruar është natyra e historisë, ku ata përkasin si subjekte dhe personalitete. Dëshmorët janë dëshmi që burimi i çlirimit dhe faktori vendimtar është vet populli, prej të cilit vijnë dhe të cilit duhet t'i shërbejnë”, u shpreh ai.

Uji nga liqeni i Badocit, sërish ka tendencë për rritje të përqendrimit të manganit

PRISHTINË, 22 SHTATOR - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK), gjatë monitorimit dhe përcjelljes së cilësisë së ujit të pijshëm, më 1 shtator ka vërejtur ngritje të vlerave të manganit në mostrat e ujit në zonën e cila furnizohet nga liqeni akumulues i Badocit. Analizat e fundit laboratorike tregojnë tendencë në rritje të përqendrimit të manganit si në ujin e liqenit, po ashtu edhe në rrjetin shpërndarës.

Kompania Rajonale e Ujësjellësit “Prishtina” ka njoftuar se edhe pse këto vlera e tejkalojnë kufirin e paraparë në Udhëzimin

Administrativ nr. 10/2021, cilësia e ujit për konsum nga njeriu deri më sot ato nuk e kanë tejkaluar standardin shëndetësor që konsiderohet se mund të ndikojë në shëndetin e njeriut.

Me qëllim të mbrojtjes së shëndetit të popullatës, IKShPK u bënë thirrje qytetarëve që furnizohen nga Fabrika e Ujit në Liqenin e Badocit, që të mos e përdorin ujin për pije deri në njoftimin e radhës.

IKShPK-ja thekson se ndotja e ujit me mangan është ndotje kimike dhe se vlimi i ujit nuk e eliminon manganin.

Uji mund të përdoret vetëm për

pastrim, mirëmbajtjen e higjienës personale dhe të ambienteve të banimit.

IKShPK ka sforcuar kontrollin e cilësisë së ujit të pijshëm si dhe bashkëpunimin me KRU “Prishtina” për ta siguruar ujin cilësor për qytetarët.

KRU “Prishtina” Sh. A. ka ndërmarrë menjëherë masat e nevojshme: zvogëlimin e sasisë së prodhimit për ta ruajtur cilësinë e furnizimit; intensifikimin e proceseve të shpëlarjes së rrjetit shpërndarës, përfshirë edhe gypat magjstralë dhe sekondarë.

Gjithashtu, për të siguruar



furnizim të pandërprerë me ujë të pijshëm për zonat e prekura (sipas hartave të prezantuara), KRU “Prishtina” do të ofrojë ujë

përmes autoboteve, në përputhje me orarin e përcaktuar dhe të paraqitur nga kompania.

AKB-ja: Kosova po mbulohet me beton, por po zbrazet nga njerëzit

PRISHTINË, 22 SHTATOR - Aleanca Kosovare e Bizneseve shpreh shqetësim për gjendjen kaotike në sektorin e ndërtimit. Statistikat tregojnë se mbi 75 % e ndërtimeve janë pa leje banimi, ndërsa mbi 180 mijë banesa mbesin bosh, shumica të blera nga diaspora, por të pashfrytëzuara. Kryetari i AKB-së, Agim Shahini, ka vlerësuar se kjo tregon mungesë të theksuar të politikave zhvillimore dhe

planifikimit urban. “Kapitali i diasporës, që duhej të ishte motor i ekonomisë, po shkon në banesa të zbrazëta e jo në prodhim, eksporte apo krijim të vendeve të punës. Ky trend rrezikon tronditje financiare dhe dëmton mirëqenien afatgjatë të qytetarëve. Po ndërtojmë qytete të zbrazëta, me banesa të pashfrytëzuara, ndërsa rinia largohet çdo ditë”, theksohet në reagimin e tij. Kreu i AKB-së kërkon nga

Qeveria e Kosovës hapa urgjentë për legalizim transparent të ndërtimeve, vendosje të rregullit dhe orientim të kapitalit të diasporës drejt prodhimit e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik. “Vetëm kështu krijohen vende të reja pune, forcohet eksporti dhe sigurohet një e ardhme më e qëndrueshme për vendin”, ka thënë Shahini, duke bërë thirrje për vizion dhe përgjegjësi në politikën zhvillimore të Kosovës.



BQK-ja DHE BQE-ja NËNSHKRUAJNË MARRËVESHJE PËR SIGURIMIN E INTEGRITETIT TË VALUTËS EURO NË KOSOVË

**EPOKA
ERE**

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 22 SHTATOR - Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) dhe Banka Qendrore Evropiane (BQE) kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi në fushën e luftimit të falsifikimit të kartëmonedhave euro, duke forcuar më tej përkushtimin institucional për ruajtjen e integritetit të parasë së gatshme euro në qarkullim dhe sigurimin e stabilitetit financiar të vendit. Marrëveshja është nënshkruar nga guvernatori i BQK-së, Ismaili dhe presidentja e BQE-së, Lagarde. Kjo marrëveshje shënon një moment të rëndësishëm në përafrimin me standardet dhe praktikën më të mira të Bashkimit Evropian në luftën kundër falsifikimit të parasë dhe vendos



bazat për një bashkëpunim teknik të strukturuar, përfshirë shkëmbimin e informacionit përmes Sistemit të Monitorimit të Falsifikimeve të BQE-së (CMS), i cili mbështet identifikimin dhe analizën e kartëmonedhave euro të falsifikuara. Përmes kësaj marrëveshje, BQK-ja do të ketë qasje në mekanizmat operativë të BQE-së të dizajnuar

për të parandaluar dhe luftuar falsifikimin e kartëmonedhave euro dhe do të integrohet në rrjetin profesional të bashkëpunimit me bankat qendrore të Eurosistemit dhe institucione partnere jashtë zonës euro, përfshirë vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor. Ky bashkëpunim është rezultat i një përpjekjeje ndërinstitucionale

në Republikën e Kosovës, e udhëhequr nga BQK-ja, në koordinim me partnerët ndërkombëtarë, veçanërisht Zyrën e Bashkimit Evropian në Kosovë, për të ndërtuar një kornizë të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse kundër falsifikimit. Marrëveshja forcon objektivat e përcaktuara në legjislacionin e përgatitur për luftimin e parasë së falsifikuar, i zhvilluar me mbështetjen e Bankës Kombëtare të Kroacisë dhe institucioneve relevante vendore, në kuadër të projektit TAIEX të BE-së, i cili parashihet nisim për krijimin e Qendrës Kombëtare Kundër Falsifikimit dhe të Sistemit Kombëtar për Monitorimin e Falsifikimeve në Kosovë, në përputhje me Planin Strategjik të BQK-së.

BQK-ja shpreh mirënjohje të veçantë për ekipin e ekspertëve që kanë punuar në këtë projekt, me vlerësim të veçantë për Bankën Qendrore Evropiane, e cila, përmes kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi, ka hapur rrugën për avancimin e kapaciteteve tona institucionale, teknike dhe operacionale, në një përpjekje të përbashkët për të luftuar një dukuri që kërkon angazhim të vazhdueshëm dhe qasje sistematike. BQK-ja riafirmojnë përkushtimin e saj për forcimin e kapaciteteve të brendshme, modernizimin dhe automatizimin e përpunimit të parasë në përputhje me standardet e Eurosistemit, rritjen e vetëdijes publike dhe avancimin e mëtejshëm drejt integritetit të plotë në praktikën e përbashkët të Bashkimit Evropian.

BRUTO PRODUKTI VENDOR PËR TREMUJORIN E DYTË SHËNON RITJE REALE PËR 4,58 %

PRISHTINË, 22 SHTATOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar të dhënat e Bruto Produktit Vendor për tremujorin i dytë (TM2) të vitit 2025, sipas aktiviteteve ekonomike dhe me qasjen e shpenzimeve, me çmime aktuale dhe me çmime të vitit paraprak. Aktivitetet ekonomike që kishin rritje në këtë tremujor ishin: Ndërtimtaria 4,15 %; Aktivitetet financiare dhe të sigurimit (8,79

%); Aktivitetet shkencore, profesionale dhe teknike, si dhe aktivitetet e shërbimeve administrative dhe mbështetëse (4,27 %); Industria përpunuese (3,34 %); Administrata publike dhe mbrojtja; sigurimi social i detyrueshëm; arsimi; shëndetësia dhe aktivitete të punës sociale (0,99 %); Tregtia me shumicë dhe me pakicë; riparimi i automjeteve dhe motoçikletave; transporti dhe



magazinimi; aktivitetet e akomodimit dhe shërbimit ushqimor (3,62 %); Arte, argëtim

dhe çlodhje, aktivitetet e prodhimit të mallrave të familjeve për përdorim të vet dhe shërbime të tjera (2,83 %); Informacioni dhe komunikimi (2,38 %); Bujqësia, pyjet dhe peshkimi (2,98 %); dhe Aktivitetet e pasurive të paluajtshme (0,44 %). Rënie kishte në këto aktivitete: Industria nxjerrëse; përpunuese; energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajër; furnizimi me

ujë; aktivitetet e trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, rehabilitimit (-6,79 %). Komponentët e BPV-së sipas metodës së shpenzimeve që kishin rritje janë: Eksporti i mallrave dhe shërbimeve (10,42 %); Importi i mallrave dhe shërbimeve (13,23 %); Formimi i bruto kapitalit (10,99 %) dhe Shpenzimet e konsumit final të ekonomive shtëpiake dhe IJPSHESH (3,91 %).

Bie numri i përfituesve të pensioneve invalidore të punës

PRISHTINË, 22 SHTATOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar statistikën e mirëqenies sociale për muajin gusht 2025. Në muajin gusht 2025, krahasuar me muajin gusht 2024, kishte rënie të numrit të përfituesve nga: skema për pensionet invalidore (-22 %);

skema për pensionet e Trepçës (-19,8 %); skema e ndihmës sociale (-13,1 %); skema për pensionet familjare (-9,1 %); skema për familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës (-2,2%); skema e pensioneve kontribut-paguesve të moshës (-1,5 %); skema e kompensimeve për

personat e verbër (-0,1 %). Në muajin gusht 2025, krahasuar me muajin gusht 2024, kishte rritje të numrit të përfituesve nga: skema për Pensionet Paraplegjike dhe Tetraplegjike (11,7 %); skema për përkrahje financiare familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara (11,6 %);

skema e pensioneve bazike të moshës (5,8 %); skema e pensioneve të Forcës së Sigurisë së Kosovës (6,4 %); skema e kompensimit për punëtorët e arsimit që punuan gjatë vitit shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99 (5 %); skema e pensioneve për personat me aftësi të kufizuara (3,7 %);



skema e pensioneve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK) (2 %); skema për veteranët e luftës (0,5 %).

TRAZIRAT NË SERBI, NGA PROTESTAT E STUDENTËVE, TEK SULMET E TABLOIDËVE

Demonstrata masive, të nxitura nga një katastrofë në stacionin e trenit, po sfidojnë qeverinë e presidentit Aleksandar Vučić



Ajo që nisi si një përkujtimore e heshtur nga një grusht studentësh vitin e kaluar është shndërruar në disa nga protestat më të mëdha në historinë e Serbisë, një lëvizje masive që disa e krahasojnë me demonstratat që e rrëzuan nga pushteti diktatorin Slobodan Millosheviç një çerek shekulli më parë. Protestat aktuale drejtohen nga studentët universitarë, dhe disa të rritur qëndrojnë pranë tyre si mbështetje, sepse ata thonë se qeveria e presidentit Aleksandar Vučić është bërë një pengesë për hyrjen e Serbisë në Bashkimin Evropian — dhe kjo është kthyer në çështjen thelbësore. Studentët po akuzojnë Vučićin dhe partinë e tij për abuzim me pushtetin, korrupsion, kapjen e mediave, dhunimin e

institucioneve, dhe po kërkojnë dorëheqjen e tij. Ata janë të përkrahur nga prindërit e tyre, grupet opozitare, si dhe OJF-të liberale në Perëndim. Gazetat e kontrolluara nga qeveria i përshkruajnë ata si “plehra” dhe “armiq të popullit.” Një nga goditjet e fundit ndaj protestuesve ishte refuzimi i autoriteteve për të lejuar një marshim përkujtimor. Kur qindra studentë u mblodhën, policia i shpërndau me dhunë.

Një krizë kombëtare

Serbia po përballet me një moment vendimtar. Vendi është në prag të një zgjedhjeje: të vazhdojë drejt një rruge autoritare, apo të hapë derën drejt demokracisë dhe integritetit në BE.

Kryeministri Vučić, i cili ka qenë në pushtet që prej vitit 2012, shihet nga kritikët si gjithnjë e më shumë autokratik. Ai ka mbushur institucionet me aleatët e tij, ka shtypur opozitën dhe ka marrë kontrollin mbi mediat. Shumë shohin ngjashmëri me vitet 1990, kur Millosheviçi e mbante Serbinë në izolim dhe krizë. Në qendër të shpërthimit aktual ishte një katastrofë hekurudhore ku dhjetëra studentë humbën jetën. Ky incident e ktheu zemërimin e akumuluar në protesta të gjera, të cilat vazhdojnë pa ndërprerje për javë të tëra.

Rinia në ballë të betejës

Studentët thonë: “Ne nuk mund të vazhdojmë të jetojmë

në një Serbi ku nuk ndihemi të sigurt, ku të ardhmen tonë e vjedhin politikanët.” Një vajzë 20-vjeçare nga Universiteti i Beogradit tha: “Prindërit e mi kanë frikë për mua, por ata e dinë që nuk mund të qëndrojmë pasive. Është koha jonë.” Ata organizojnë marshime, shpërndajnë mesazhe me hashtage si #SerbiaWithoutVučić dhe refuzojnë të ndalen.

Mediat dhe reagimi ndërkombëtar

Mediat e pavarura, gazetarët dhe organizatat për të drejtat e njeriut po e mbulojnë ngjarjen gjerësisht, ndërsa tabloidet pro-qeveritare përpiqen t'i diskreditojnë protestuesit duke

i quajtur “armiq të shtetit.” Reporterët pa Kufij dhe Federata Evropiane e Gazetarëve kanë denoncuar dhunën dhe kërcënimet ndaj gazetarëve që mbulojnë protestat. BE ka dhënë sinjale se po ndjek nga afër zhvillimet dhe ka paralajmëruar se dhuna dhe mungesa e reformave do ta vonojnë procesin e anëtarësimit. Pyetja që shtrohet sot është: A do të mundet rinia serbe të ndryshojë trajektoren e vendit? Ose a do të përballet Serbia me një të ardhme të zymtë të izolimit, nacionalizmit dhe autoritarizmit? “Ne jemi këtu,” tha një student. “Sepse nuk kemi rrugë tjetër.” / me shkurtime nga Washington Post – bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Prishtina e Re shkarkon Berishën, angazhon Babajn

PRISHTINË, 22 SHTATOR - Elon Berisha nuk është më trajner i Prishtinës së Re, ekip që ka debutuar këtë sezon në Superligë. Berisha është larguar nga skuadra që e ka drejtuar për shumë vjet dhe e

ka promovuar në elitën e futbollit të Kosovës, një ditë pas humbjes 2:1 nga Drita në kuadër të xhiros së pestë. Mësohet se Prishtina e Re ka ndarë rrugët me Berishën pasi ekipi nuk ka treguar formë të

mirë këtë sezon, ku në pesë ndeshje ka tubuar 6 pikë pas dy fitoreve e tri humbjeve. Berishën në pozitën e trajnerit do ta zëvendësojë Shpëtim Babaj, i cili ishte drejtor sportiv, rol në të cilin ishte

angazhuar para fillimit të sezonit. Babaj në krye të Prishtinës së Re pritet të debutojë në ndeshjen kundër Prishtinës, e cila i takon xhiros së gjashtë të elitës së futbollit të Kosovës.



ROBERT RRAHMANI, “YLLI I JAVËS” NË SUPERLIGË

PRISHTINË, 22 SHTATOR - Federata e Futbollit e Kosovës (FFK), në bashkëpunim me sponsorin zyrtar të Superligës, Albi Mall, vazhdon ta japë çmimin tradicional “Ylli i Javës”, që i dedikohet futbollistit më të dalluar të javës në elitën e futbollit kosovar. Për javën e pestë të këtij edicioni ky çmim i është ndarë futbollistit të SC Gjilanit, Robert Rrahmani, i cili, përveç paraqitjes fantastike, ishte edhe shënuesi i golit të vetëm në ndeshje, me të cilin skuadra gjilanase fitoi tri pikë të

rëndësishme (0:1). Vlerësimi është bërë nga Komisioni i Veteranëve të Futbollit, i përbërë nga Blerim Haxholli, Isuf Llumnica dhe Denis Isaja. Pasi ka marrë këtë çmim, Rrahmani është shprehur i lumtur që u vlerësua si lojtari më i mirë i javës: “Për ndeshjen kundër Ferizajt jemi përgatitur shumë mirë dhe qëllimi ynë ka qenë vetëm fitorja dhe marrja e 3 pikëve. Nuk kemi pasur si synim as lojën e bukur, as të dalim nga detyrat tona. Trajneri na e ka

bërë të qartë që duhet të luftojmë vetëm për tri pikë. Për Gjilanin, angazhimi dhe shpërblimi janë trofetë gjithsesi, sepse kemi një fond shumë të mirë lojtarësh dhe konkurrenca është e madhe dhe e shëndoshë. Nuk kemi më hapësirë për gabime. E falënderoj FFK-në për çmimin e dhënë dhe këtë çmim ia dedikoj bashkëlojtarëve për angazhimin dhe mundin e treguar, sepse edhe ata janë pjesë e këtij çmimi”, ka thënë ai për faqen zyrtare të FFK-së.



MARASH KUMBULLA U LËNDUA NË FUNDJAVË, RREZIKON LOJËN NDAJ SERBISË

TIRANË, 22 SHTATOR - Ishte titullar edhe pse kishte pasur probleme. Trajneri i Mallorcas, Arrasate, duket se nuk mund të bëjë pa Marash Kumbullën, duke e futur në fushë në ndeshjen tepër të rëndësishme në La Ligë ndaj Atletico Madridit. Gjithsesi, qëndrimi në terren i mbrojtësit të kombëtares shqiptare nuk ka vazhduar më shumë se 36 minuta pasi ai ka ndier shqetësime fizike dhe është zëvendësuar. Nuk dihet se për çfarë lëndimi bëhet fjalë dhe se sa do të jetë koha e riaftësimit. Mallorca e tij arriti barazimin 1-1 në fund pas golit të shënuar nga sulmuesi kryesor i Kosovës, Vedat Muriqi. Natyrisht, për Kumbullën do të ketë vizita mjekësore gjatë kësaj jave. Shpresa është që futbollisti i kombëtares të mos ketë dëmtim të rëndësishëm, ndërsa afron



ndeshja ndaj Serbisë në eliminatoret e Kupës së Botës. Lojtari 25-vjeçar ka qenë në fushë në 67 për qind të minutave në kampionat dhe, po ashtu, ka qenë titullar për Mallorcan në 75 për qind të ndeshjeve, pra në tre nga katër. Ai ka vendosur ta vazhdojë karrierën në Spanjë pasi është paraqitur mjaft mirë sezonin e kaluar tek Espanyoli,

gjithashtu në elitën e futbollit të këtij vendi. Luajti plot 35 ndeshje nga 38 gjithsej për skuadrën katalanase, duke shënuar 3 gola e duke qenë ndër më të mirët, por klubi nuk ka mundur ta mbante për shkak të rrogës së lartë që merrte te Roma, e cila e kishte huazuar, dhe tani e ka huazuar për herë të dytë.

VEDAT MURIQI KONFIRMON FORMËN JETËSORE

MALLORCA 22 SHTATOR - Sulmuesi i Kombëtares së Kosovës, Vedat Muriqi, këtë sezon nuk ka të ndalur, pasi edhe në ndeshjen e fundit ka konfirmuar formën jetësore. Muriqi ia ka siguruar një pikë të madhe Mallorcas, pasi ka shënuar gol për barazimin 1:1 kundër Atletico Madridit, të dielën mbrëma në kuadër të xhiros së pestë të La Ligas. Për sulmuesin 31-vjeçar ky është goli i katërt në paraqitjet e para në kampionat, dhe është starti më i mirë i tij në një sezon në Spanjë. Në fakt, Muriqi katër golat i ka

shënuar në tri ndeshjet e fundit, pasi ka realizuar një gol edhe kundër Real Madridit dhe dy të tjerë ndaj Espanyolit. Muaj më parë Muriqi e ka vazhduar kontratën deri në vitin 2027 me Mallorcan, ekip që aktualisht zë pozitën e parafundit në La Liga. Forma e Muriqit është sinjal fantastik për Kombëtaren e Kosovës pasi muajin tjetër përballet me Slloveninë e Suedinë në kuadër të kualifikimeve për Botërorin e vitit 2026. Këtë muaj Muriqi ka realizuar gol për “Dardanët” në fitoren e madhe, 2:0 ndaj Suedisë në Prishtinë.



Blerim Xhemaili angazhohet analist në televizionin zviceran

BERNË, 22 SHTATOR - Ish-futbollisti i njohur Blerim Xhemaili është punësuar ekspert i futbollit në televizionin zviceran “Blue Sport”. Xhemaili do t'i komentojë

ndeshjet e klubeve zvicerane në garat evropiane. Baseli, Young Boysi dhe Lausanne janë ekipet zvicerane që këtë edicion janë pjesë e Ligës së Evropës dhe Ligës së

Konferencës. Pos Xhemailit, edhe ish-futbollisti Michael Lang është angazhuar ekspert. 39-vjeçari Xhemaili ka karrierë të pasur si futbollist. Ka luajtur

në skuadra si Torino, Parma, Napoli, Galatasaray, Genoa, Bologna e Zurich. Për Përfaqësuesen e Zvicrës, Xhemaili ka zhvilluar 69 ndeshje dhe ka realizuar 11 gola.





Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Micom-M Plus” SH.P.K. me seli në Leposaviç, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr.b. 810699655 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTEN.JE

Obavestavanje se svi klijenti da društvo sa “Micom-M Plus” D.O.O. Leposavic donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810699655 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klijenti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “Micom-M Plus” L.L.C. with headquarters Leposaviç, has come to the decision to quit its business: 810699655 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidation process. All clients who have the mortgagor – mortgage accounts in this company are kindly requested to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- B.I. "ILLCOM" nga Gjakova, shpall të pavlefshme numrin UNIK identifikues: 811412981 të lëshuar nga ARBK.

- Drlon Xëerxa nga Gjakova, shpall të pavlefshme dëftesat e klasës: 10,11,12,13 të shkollës së mesme profesionale "Gjon N. Kazazi", Gjakovë.

- Granit Morina nga Gjakova shpall të pavlefshme Sh.M.Ekonomike "Kadri Kusari", Gjakovë.

- NNSH "Meridian", shpall të pavlefshme numrin UNIK të biznesit: 810227406, të lëshuar nga ARBK.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishtme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.


- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



044 900 978 | 045 681 898

 [Sallon Depilimi Lume's Details](#)

 [lumesdetails](#)

 Albrapa Teatr it, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi





ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



Columbus, Georgia, USA
Since 1906

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

